

# Më dhuro një përrallë

## Family Literacy



Një projekt për nxitjen e leximit  
në familje



Ju si prindër jeni ekspertë për zhvillimin gjuhësor dhe për mbështetjen gjuhësore të fëmijëve tuaj. Këtu ju mund të gjeni sugjerime, se si ju mund ta zgjoni tek fëmija juaj dëshirën për gjuhën dhe leximin.

## Të eksplorosh shkrimin së bashku


Shenjat e shkrimit dhe simbolet e mahnitin fëmijën tuaj. Me ndihmën tuaj ai mund të zbulojë sekretet e shkrimit në rrugën e duhur. Letra dhe lapsat e ftojnë atë për eksperimentim.



## Të shkojmë në bibliotekë

Librat mund të bëhen shokë të ngushtë.

Në bibliotekë ju së bashku me fëmijën tuaj mund të huazoni libra për në shtëpi.



## Të përkrahurit e shumë gjuhëve

Fëmija juaj mund të mësojë njëkohësisht fare mirë dy apo tre gjuhë. Por këtu duhen rregulla të qarta, se kur cila gjuhë duhet folur kur.



## Krijim kontaktesh

Mos u shqetësoni: në kontakt me fëmijët e tjerë dhe të rriturit, fëmija juaj e mëson shpejt gjermanishten. Mundësojini ju atij kontakte të tilla si p.sh.: në grupe loje (Spielgruppe) ose në çerdhe.



## Të folurit në gjuhën amëtare

Nëse ju flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë që ju e zotëroni më mirë, i jepni kështu atij një bazë të sigurtë për mësimin e gjuhëve të tjera.



### **Nxitja për lexim: familja luan një rol vendimtar**

Përvojat e larmishme në të shkruar si dhe një trajnim i mirë i gjuhës mëmë është baza më e mirë për mësimin e gjuhës gjermane dhe mësimin e leximit në shkollë. Projekti Më dhuro një përrallë – Family Literacy i Institutit Zvicëran për Mediat e fëmijëve dhe të rinjve SIKJM mbështet prindërit për t'ii nxitur fëmijët e tyre në gjuhë dhe lexim, si dhe inkurajon këto familje me prejardhje emigruese që të ruajnë gjuhën e tyre amëtare.

## Dëgjoni dhe jepni përgjigje

Fëmija juaj e zhvillon gjuhën e tij nëpërmjet bisedës me ju. Nëse ju flisni me të për vëzhgimet e tij, ai e zgjeron fjalorin e tij dhe kështu i lind dëshira për të zbuluar gjëra të reja.



## Animacione për prindër dhe fëmijë nga 2 deri 5 vjeç

Prindërit dhe fëmijët takohen rregullisht së bashku në një orar të caktuar për të dëgjuar tregime në gjuhën e tyre amtare. Animatorija ju fton që të dëgjoni përralla, të luani, të këndonni këngë dhe lexoni vargje poezish, të shikoni libra me figura dhe shumë e shumë gjëra të tjera. Animacionet janë falas për familjet pjesmarrëse. Ato zhvillohen në bibliotekë, në qendrat e lagjeve dhe në kopshtet e fëmijëve. Vizitat shtëpiake mundësojnë krijimin e kontakteve personale.

## Kënaqesia e përbashkët për gjuhën

Me gjuhën mund të luhet më së miri. Nëpërmjet vjershave, këngëve dhe lojërave me lëvizje fëmija juaj e përjeton atë në mënyrë shumë zbavitëse.



## Arsimim të mëtejshëm për ndërmjetësuesit interkulturore

Animatorët e projektit Më dhuro një përrallë – Family Literacy, janë ndërmjetësuesit interkulturore dhe mësuesit e grupeve të lojës (Spielgruppe). Ata arsimohen më tej nga SIKJM dhe shoqërohen profesionalisht.



## Të tregosh përralla dhe të shikosh figura

Tregimet dhe figurat i hapin fëmijës tuaj botë të reja. Ai mund t'i eksplorojë ato së bashku me ju dhe të njohë shumë terma të reja.



## Gjuhë të ndryshme

Animacionet gjuhësore janë zhvilluar duke iu përshtatur numrit të migrantëve në shqip, arabisht, gjermanisht, frëngjisht, në gjuhën kurde, portugalisht, në gjuhën boshnjake/kroate/serbe, spanisht, tamile, tigrinya dhe turke. Sipas nevojave mund të shtohen edhe gjuhë të tjera.

## Bibliotekat interkulturore

Bibliotekat interkulturore në Zvicër ofrojnë libra në shumë gjuhë të ndryshme. Ata janë të organizuara në organizatën Interbiblio. [www.interbiblio.ch](http://www.interbiblio.ch)

## Bibliomedia Zvicër

Bibliomedia Zvicër huazon libra në dymbëdhjetë gjuhë të ndryshme bibliotekave të qytetit, komunave, si edhe mësuesve dhe bibliotekave të shkollave.

[www.bibliomedia.ch](http://www.bibliomedia.ch)

## Instituti Zviceran për Mediat e fëmijëve dhe të rinjve SIKJM

Instituti Zviceran për Mediat e fëmijëve dhe të rinjve SIKJM ka sjellë në jetë në vitin 2006 projektin Më dhuro një përrallë – Family Literacy. Në 2008-tën ai u vlerësua me çmimin Alpha nga Komisioni i Unesco-s për të luftuar dobësitë në shkrim e lexim si dhe për përkrahjen e dialogut interkulturor. SIKJM angazhohet për zhvillimin e mëtejshëm të projektit Më dhuro një përrallë – Family Literacy në të gjithë Zvicrën.

Nxitja për lexim, kërkimi shkencor dhe dokumentacionet në fushën e letërsisë së fëmijëve dhe të rinjve janë detyrat kryesore të SIKJM-së, e cili ka degë të tij edhe në Romandie dhe në Tessin. Ai Përkrahjet gjithashtu nga Zyra Federale e Kulturës, nga sekretariati Shtetëror për Arsim dhe Shkencë si dhe nga Kantoni dhe Qyteti i Zyrihut.

# SIKJM

**Schweizerisches Institut  
für Kinder- und Jugendmedien SIKJM**

Georgengasse 6  
8006 Zürich  
Tel. 043 268 39 00  
[info@sikjm.ch](mailto:info@sikjm.ch)  
[www.sikjm.ch](http://www.sikjm.ch)

